



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 672 prot.

Tiranë, më 26. 04. 2022

V E N D I M

Nr. 81, datë 26 . 04 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 66 Regj., datë 13.04.2022, e shtetasit A. K, kundër Komisarariatit të Policisë Kavajë, me pretendim diskriminimin për “çdo shkak tjetër”².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Oficerë të policisë në Komisariatin e Policisë Kavajë, në shenjë hakmarrjeje ndaj meje, për shkak të detyrës që unë kisha më herët, kanë përpiluar informacione policore dhe akte procedurale të rreme për mua dhe dy djemtë e mi, se gjoja unë dhe djemtë e mi merremi me shitje narkotikësh. Këto informacione janë përpiluar në shenjë hakmarrjeje në lidhje me detyrën që unë kam pasur më herët. Në periudhën mars-maj të vitit 2020 kam qenë me detyrë specialist për hetimin në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) dhe mbuloja

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Ankuesi ka shënuar “çdo shkak tjetër” tek lista me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në formularin e ankesës pranë KMD-së, duke cilësuar se referon tek ky shkak denoncimet që ka bërë ai për shkak të detyrës kundrejt disa oficerëve të policisë së Komisarariatit të Policisë Kavajë, për shpërdorim detyre.

Komisariatit e Policisë Kavajë. Gjatë asaj periudhe kisha referuar akte procedurale ndaj pesë oficerëve të policisë së këtij Komisariati, për shpërdorim detyre, pasi ata kishin lejuar dhjetëra ndërtime të paligjshme në bregdetin e Golemit, kundrejt përfitimit të të mirave materiale për vete dhe eprorët e tyre.

Me datë 25.05.2020 jam tërhequr nga SHÇBA, me arsyetimin “me kërkesën time”, por që realisht u tërhoqa për shkak të presioneve dhe kërcënimeve që kanë ardhur ndaj meje, nga të afërm të këtyre oficerëve të policisë, nga persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore të lidhur me oficerë policie, me segmente shtetërore si në pushtetin vendor, ashtu dhe atë qendror, kërcënime këto për shkak të detyrës sime.

Një muaj pasi unë isha tërhequr nga kjo detyrë, ata në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në mënyrë diskriminuese ndaj nesh kanë përpiluar informacione policore dhe akte procedurale të rreme, me qëllim shkatërrimin e të ardhmes time dhe të dy djemve të mi, duke na privuar nga shumë të drejta të ligjshme, si: rikthimi im në strukturat e Ministrisë së Brendshme, pamundësinë e shkollimit të dy djemve të mi në Akademinë e Sigurisë Publike, pamundësinë për të punuar në shtet apo për të hapur një biznes si nënkontraktues me institucione financiare, mospajshjen me vizë për dalje jashtë shtetit, etj.

Si mund të lejohen këta oficerë të Policisë së Shtetit, që në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore të përpilojnë dhe regjistrojnë informacione të tilla policore, e aq më keq të lejohen edhe nga zinxhiri komandues? Këto informacione të hedhura në sistemet dhe në kartotekën e Policisë së Shtetit mbeten aty përjetë dhe na privojnë nga shumë të drejta. Pra, haptazi dhe qartë kemi të bëjmë me veprime arbitrare, të kryera me dashje nga oficerë të Policisë Kavajë, të cilët qëllimisht për hakmarrje personale, kanë shfrytëzuar atributet që u jep detyra, duke përpiluar akte procedurale mbi fakte të rreme, me qëllim përndjekjen time dhe të familjarëve të mi, e lejuar dhe e diktuar kjo nga zinxhiri komandues i këtij Komisariati Policie, veprime këto të dënueshme që parashikohen në nenet 25, 248 dhe 250, të Kodit Penal.

Në lidhje me këtë episod, me datë 17.03.2022 kam bërë kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, ndaj shtatë oficerëve të policisë, për veprat penale të parashikuara në legjislacionin penal.

Si pasojë e punës sime në Policinë e Shtetit, si dhe në SHÇBA, në mënyrë hakmarrëse ndaj meje, jam marrë nën hetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), ku mbahem në masë arresti në shtëpi, pa asnjë fakt dhe provë konkrete. Kjo gjë bëhet për të më bërë presion dhe për t'u hakmarrë e më mbyllur gojën, pasi unë di shumë”.

Subjekti ankues në parashtrimet e tij ka evidentuar edhe një moment tjetër, i cili lidhet me periudhën maj-dhjetor të vitit 2016, kur ai ishte me detyrë specialist në Komisarariatit e Policisë

Kavajë. Lidhur me këtë moment, ai shpjegon se: “Në muajin dhjetor 2016 kam referuar akte procedurale në Prokurorinë për Krimet e Rënda në Tiranë, në ngarkim të disa shtetasve, për t’u ndjekur me metoda proaktive për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a, i Kodit Penal. Këto akte procedurale kanë shërbyer për regjistrimin e procedimit të famshëm penal me nr. 339/2016. Dy vite pas ekzekutimit të masave të sigurimit në lidhje me këtë procedim penal, jam internuar në Drejtorinë e Policisë Shkodër, me ulje në detyrë, pa motivacion.

Në lidhje më këtë internim në fund të muajit dhjetor 2018 dhe janar të vitit 2019, i jam drejtuar me ankesë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si dhe Ministrin të Brendshëm”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, shprehimisht:

“Verifikimin dhe analizimin e këtij rasti flagrant, në kundërshtim me ligjin, si dhe marrjen e masave për evidentimin e shkeljeve penale, të kryera nga oficerët e policisë së Komisarariatit të Policisë Kavajë. Njëherësh edhe ndihmesën ligjore për asgjësimin dhe pastrimin e informacioneve dhe të dhënave të rreme, të përpiluara në shenjë hakmarrjeje, përndjekjeje dhe diskriminimi ndaj meje dhe dy djemve të mi, për të cilat nëse nuk do të vlerësohen dhe të hiqen do të jetë një padrejtësi dhe barrë shumë e rëndë për ne”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: ““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që

krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Së pari, lidhur me kërkimin e ankuesit për evidentimin e shkeljeve ligjore të kryera nga oficerët e policisë pranë Komisarariatit të Policisë Kavajë, kundrejt tij, duke u bazuar në të dhëna e informacione të rreme, të përpiluara në shenjë hakmarrjeje, përndjekjeje e diskriminimi ndaj tij dhe fëmijëve të tij, Komisioneri vlerëson se:

- Bazuar në Kallëzimin me nr. 177, datë 17.03.2022 të subjektit ankues dhe Vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, me nr. 1481 prot., datë 01.04.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, rezulton që këto pretendime janë shqyrtuar nga organi kompetent, Prokuroria në fjalë, e cila ka dalë me një vendim lidhur me rastin e hetuar prej saj.
- Bazuar në deklaratimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti ankues, rezulton se, ankuesi, me datë 06.04.2022, ka paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, kërkesë ankimore kundër vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, me nr. 1481 prot., datë 01.04.2022.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se punonjësit e policisë së Komisarariatit të Kavajës, kanë shpërdoruar detyrën përmes falsifikimit të dokumentacionit, përpilimit e hartimit të akteve proceduriale të rreme e shpifjes dhe sajimeve kundrejt tij dhe familjarëve të tij, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.³

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: “*Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në*

³ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale....*”

kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojtë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.

Neni 186⁴, i Kodit Penal, përcakton se: *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.*

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunimi ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet”.

Neni 248⁵, i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.*

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.*

Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.

Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.

Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.

Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi i vendimeve të organeve gjyqësore të tilla si prokuroria apo gjykatat bëhet sipas hierarkisë, në shkallët më të larta të gjykatave respektive dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 291⁶, të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të prokurorit, ka përcaktuar se:

⁴ Falsifikimi i dokumenteve.

⁵ Shpërdorim i detyrës.

⁶ Vendimi për mosfillimin e procedimit.

“1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura.

4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.

5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”, të drejtë të cilën ankuesi e ka ushtruar pranë Gjykatës, nëpërmjet ankimit të tij me datë 06.04.2022, çështje e cila aktualisht është në fazën e gjyqimit pranë këtij organi.

Nëse ankuesi nuk do të jetë dakord as me vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, lidhur me pretendimet e tij, atij i lind e drejta e ankimit të vendimit në gjykatën e apelit, bazuar në dispozitat ligjore specifike.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese⁷, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.*

⁷ *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”.*

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrohen veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet vendimmarrjes së çështjes konkrete. Asnjë pushtet apo organ tjetër nuk mund të veprojë si gjykatë dhe të marrë kompetencat e saj.

Pretendimet e ankuesit mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundravajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë⁸, apo për më tepër kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁹.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”.

Së dyti, lidhur me pretendimin e ankuesit, se pasi është dorëhequr nga SHÇBA (me datë 25.05.2020), për shkak të detyrës që ka ushtruar, është kanosur, kërcënuar dhe ushtruar presion ndaj tij dhe familjarëve të tij nga të afërm të punonjësve të policisë së Komisarariatit të Policisë Kavajë (pas denoncimit të tyre për shpërdorim detyre, prej ankuesit në instancat përgjegjëse), persona këta me rrezikshmëri të lartë dhe të lidhur me segmente shtetërore si në pushtetin vendor dhe atë qendror, Komisioneri informon subjektin ankues se, shqyrtimi i një fakti të tillë nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 238 i Kodit Penal, sanksionon se: “Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të

⁸ Falsifikimi i dokumentave, informacioni i rremë nga zyrtarë shtetërorë apo shpifja e kanosja, të pretenduara nga subjekti ankues.

⁹ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021, të KMD-së.

veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Komisioneri i sugjeron subjektit ankues, se mund të ndjekë procedurën ligjore për kallëzim pranë organit të Prokurorisë, i cili në bazë të Kushtetutës dhe ligjit është organi kompetent që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç)..... është haptazi e pabazuar.”, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Së treti, lidhur me pretendimin e ankuesit për sa i takon uljes në detyrë dhe transferimit të tij në strukturat e Drejtorisë së Policisë Shkodër, në periudhën dhjetor 2018-janar 2019, ardhur si shkak i hakmarrjes ndaj tij pasi ai kishte hartuar aktet proceduriale të përdorura për regjistrimin e procedimit penal me nr. 339/2016, Komisioneri vlerëson se:

- Bazuar në deklaratimet e subjektit ankues, rezulton se, pretendimet e tij lidhen me momentin e transferimit të tij në Drejtorinë e Policë Shkodër, pra me periudhën kohore dhjetor 2018-janar 2019. (*fakt për të cilin ai pohon dhe marrjen dijani po në këtë periudhë*).
- Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka marrë dijani për transferimin e tij (fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që në muajt dhjetor 2018-janar 2019. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 13.04.2022, pra më vonë se dy vjet nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “4. Ankesa nuk prahohet nëse:....dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuuese”, ky kërkim i shtetasit A. K, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç/dh, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues A. K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Çdo shkak tjetër

Lloji i vendimit: Mospranim